



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "H&B Consulting" Sh.P.K. të datës 31.07.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 18.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i thertores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "H&B Consulting" Sh.P.K. e datës 31.07.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 18.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i thertores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.
- II. **VËRTETOHET** njoftimi mbi kontratë i datës 18.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "H&B Consulting" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "H&B Consulting" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 31.07.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 18.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i thertores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim - "Ne kemi identifikuar disa kritere të caktuara që vlerësojmë se janë diskriminuese dhe kufizojnë operatorët ekonomik në mënyrë të parregullt duke shkelur LPP. Kriteret dhe dëshmitë e kërkuara dokumentare/mostrat në FDT pikat:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i>
		2.Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqes. Inxhinier i elektros I, të jetë auditor i energjisë i certifikuar me standardet EN 16247 në ndriçim publik. Të ketë të përfunduar studimet min. nivelin master në eficiencë të energjisë. Inxhinieri duhet të ketë përvojë në auditime të energjisë të specifikuar në ndriçim publik e referenca në auditim të energjisë dhe me përvojë punë në këtë lami min. 3 vite të dëshmohet me referenca- të dorëzohet diploma e inxhinierit e noterizuar.	2.Dëshmitë e kërkuara; Operatori Ekonomik, duhet të ofrojë dëshmi CV-ja ,diploma, Referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit. (Për stafin që nuk gjendet në marrëdhënie pune të ofrohet kontratë për angazhim në emër të projektit, kontrata duhet të jetë e noterizuar në mes të Inxhinierit dhe Punëdhënësit) -
		4.Autorizimi nga prodhuesi ose distributori i produkteve për pozicionet 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7, 16.10, 16.12, 17.8, 17.9, 17.10, 19.1, 19.2, 19.3, 19.4, 19.5, 19.6, 19.7, 19.8, 19.15, 26.5, 29.1, 29.11, , 30.1,	4.Kopja e Autorizimit të prodhuesit apo distributorit të Autorizuar.
		5.Katalogu nga prodhuesi me specifika për pozicionet 7.1, 7.2, 8.2, 8.3, 9.1, 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7, 12.1, 12.2, 12.3, 12.4, 12.6, 12.7, 12.8, 12.9, 12.10, 12.11, 12.12, 12.13, 12.14, 12.15, 12.16, 12.17, 12.18, 13.1, 16.10, 16.12, 17.8, 17.9, 17.10, 19.1, 19.2, 19.3, 19.4, 19.5, 19.6, 19.7, 19.8, 23.1, 23.2, 23.3, 23.4, 26.5, 28.1, 28.2, 28.3, 28.4, 28.5, 28.6, 28.7, 28.8, 28.9, 28.10, 28.11, 28.12, 28.13, 28.14, 28.18, 29.1, 29.11, 29.14, 29.15, 30.1, 30.2.	5. Kopja e katalogut për pozicionet e kërkuara
		6.Garancioni minimum 1 vite nga prodhuesi për pozicionet , 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7,16.10, 16.12, 26.5, 29.1, 29.11, 19.15, 30.1.	6. OE-ik duhet të ofrojë një deklaratë të vulltosur dhe nënshkruar për Garancionin nga prodhuesi min. 1 vite për pozicionet e kërkuara .
		7.Test Raporti për pozicionet 16.10 dhe 16.12 sipas standardit EN 12390-8 dhe ENEC cetrifika për pozicionin 26.5.	7.OE-ik duhet të dorëzojë Test Raportin sipas standardit EN 12390-8 për pozicionet e kërkuara.
		8.Duhet të dorëzohen mostrat për produktet në pozicionet 7.2, 8.3, 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7,12.1, 12.11, 12.12, 12.13, 12.14, 12.15, 12.16, 12.17, 12.18,13.1, 16.10, 16.12, 17.8, 17.9, 17.10, 19.1, 19.2, 19.3, 19.4, 19.5, 19.6, 19.7, 19.8, 23.1, 23.2, 23.3, 23.4, 24.5, 26.5, 26.7, 26.8, 26.9, 26.10.	8. Mostrat duhet të dorëzohen në ditën hapjes së ofertave para orës 13 30 në Sektorin e Prokurimit - (Komuna Vjeter).
		9.Duhet të dorëzohen ISO certifikatat nga prodhuesit e produkteve për pozicionet 7.1, 7.2, 8.2, 8.3, 9.1, 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7, 12.1, 12.2, 12.3, 12.4, 12.6, 12.7, 12.8, 12.9, 12.10, 12.11, 12.12, 12.13, 12.14, 12.15, 12.16, 12.17, 12.18, 13.1, 16.12, 17.8, 17.9, 17.10, 19.1, 19.2, 19.3, 19.4, 19.5, 19.6, 19.7, 19.8, 28.1, 28.2, 28.3, 28.4, 28.5, 28.6, 28.7, 28.8, 28.9, 28.10, 28.11, 28.12, 28.13, 28.14, 28.18, 29.1, 29.11, 29.14, 29.15, 30.1, 30.2.	9.Kopjet e qertifikates për pozicionet e kërkuara.
		10.Duhet të dorëzohen DoP(Declaration of performance) nga prodhuesit e produkteve për pozicionet 7.2, 8.2, 8.3.	10.OE-ik duhet të dorëzojë DoP(Declaration of performance) nga prodhuesi për produktet për pozicionet 7.2, 8.2, 8.3.
		11.Duhet të dorëzohen CE certifikatat nga prodhuesit e produkteve për pozicionet 11.1, 11.2, 11.3, 11.4, 11.5, 11.6, 11.7, 12.1, 12.2, 12.3, 12.4, 12.6, 12.7, 12.8, 12.9, 12.10, 12.11, 12.12, 12.13, 12.14, 12.15, 12.16, 12.17, 12.18, 28.1, 28.2, 28.3, 28.4, 28.5, 28.6, 28.7, 28.8, 28.9, 28.10, 28.11, 28.12, 28.13, 28.14, 29.1, 29.11, 29.15, 30.1, 30.2.	11.Kopjet e qertifikates për pozicionet e kërkuara.
		12.Duhet të dorëzohen EUROVENT certifikatat nga prodhuesit e produkteve për pozicionet 29.1, 29.11, 19.15, 30.1.	12.Kopjet e qertifikates për pozicionet e kërkuara.

Faqe 2 nga 4

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

- Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 vlerësojmë se janë të pa arsyeshme për fazën e tenderimit dhe kufizojnë konkurrencën, andaj kërkojmë që këto kërkesa të plotësohen prej OE që do të shpërblehet me kontratë gjatë fazës së implementimit.
- Kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës për kualifikimet e kërkuara për inxhinierin e elektros 1. Të ketë përfunduar studimet min. nivelin master në eficiencë të energjisë. Vlerësojmë se është kërkesë diskriminuese.
- Në lidhje me të gjitha këto kërkesa kërkojmë që kriteret e dosjes së tenderit të rivlerësohen dhe ndryshohen në përputhje me LPP dhe parimet e barazisë së trajtimeve”.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 7 të LPP.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 07.08.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 60 paragrafit 60.3 nënparagrafi f) të RRPP përcaktohet se kërkesa për rishqyrtim ndër të tjera duhet edhe të “përshkruan rrethanat faktike që përbëjnë apo prodhojnë shkeljen e pretenduar”. Në rastin konkret parashtruesi vetëm ka cituar pothuajse të gjitha kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 në mënyrë identike siç janë të përcaktuara edhe në dosjen e tenderit. Përshkrimin e vetëm që e ka bërë parashtruesi në kërkesën e tij për rishqyrtim “ne kemi identifikuar disa kriteret të caktuara që vlerësojmë se janë diskriminuese dhe kufizojnë operatorët ekonomik në mënyrë të parregullt duke shkelur LPP”. Me fjalë të tjera në kërkesën për rishqyrtim nuk janë përshkruar arsyet pse parashtruesi pretendon që kërkesat përkatëse në dosjen e tenderit mund të jenë diskriminuese/favorizuese. Nëse pretendimi i ankimor i parashtruesit është se një kërkesë e dosjes së tenderit është diskriminuese/favorizuese atëherë duhet patjetër që të shpjegohen edhe argumentet se ku bazohet ky pretendim ankimor. Në fakt duhet të shpjegohen në mënyrë të detajuar arsyet pse parashtruesit mendon që kërkesat e caktuara janë diskriminuese/favorizuese. Nuk është aspak e mjaftueshme që vetëm të thuhet se një kërkesë e caktuar e dosjes së tenderit është diskriminuese nëse nuk sqarohen detajisht edhe arsyet dhe argumentet se ku mbështetet ky pretendim ankimor. Për më tepër nga parashtruesi pritet që në kërkesë të bashkangjitet edhe një propozim se si mund të përmissohet shkelja e pretenduar e Autoritetit Kontraktues. Në rastin konkret në vend të këtij propozimi parashtruesi vetëm ka thënë se “në lidhje me të gjitha këto kërkesa, kërkojmë që kriteret e dosjes së tenderit të rivlerësohen dhe ndryshohen në përputhje me LPP dhe parimet e barazisë së trajtimeve”. Në këtë mënyrë është gjetur se kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit nuk është në përputhje me nenin 60 paragrafin 60.3 nënparagrafin f) të RRPP. Pavarësisht këtij fakti, lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit zyrtari përgjegjës i prokurimit me datë 1 gusht 2023 ka kërkuar nga njësia kërkuuese që të rivlerësojë nëse kërkesat në dosjen e tenderit janë në përputhje me LPP. Rrjedhimisht me datë 2 gusht 2023 njësia kërkuuese është përgjigjur ashtu që nuk ka gjetur mospërputhje mes kërkesave të dosjes së tenderit dhe LPP me arsyetimin si në vijim: “Si njësi e kërkesës e kemi obligim të sigurohemi që stafi i angazhuar nga OE të jetë profesional dhe materiali i shfrytëzuar të përmbushë standardet më të

larta (europiane) në mënyrë që të sigurohet një cilësi e lartë e punimeve. Na lejoni të ju përkujtojmë se ky projekt (therrtore publike) është shumë specifik që kërkon përveç tjerash edhe kompetencë të lartë profesionale, pasi që mos zbatimi i standardeve të larta tekniko- profesionale mund të rrezikoj edhe shëndetin publik. Për këtë edhe kërkesat janë të tilla që të sigurohet një cilësi e lartë e punimeve”.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.1 nënparagrafit b) të RRPP është përcaktuar se njësia e kërkesës e cila ka inicuar aktivitetin e prokurimit ndër të tjera ka përgjegjësinë që të “Përgatit/proponon detyrën projektuese, projektin, specifikime teknike (ST), Termat e Referencës (TeR), dhe Paramasen dhe Paralogarinë”. Në rastin konkret njësia kërkuese ka përgjegjësinë e plotë për kërkesat sipas dosjes së tenderit të publikuar lidhur me aktivitetin përkatës të prokurimit. Sa i përket pretendimit ankimor me rastin e sigurimit të përgjigjes së cituar më sipër nga njësia kërkuese, zyrtari përgjegjës i prokurimit ka përmbushur përgjegjësitë e tij në kuptim të nenit 11 par. 11.3 nënpar. b) të RRPP ku përcaktohet se zyrtari i prokurimit “në bashkëpunim me Udhëheqësit e Njësive kërkuese, koordinon të gjitha dokumentet, projektet, specifikimet, TeR, Paramasat dhe Paralogaritë dhe vizatimet”. Lidhur me pretendimet ankimore zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë përgjigjes së njësisë kërkuese të cituar më lartë.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 07.08.2023

Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.